



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1694/1 Prot.

Tiranë, më 05 / 12 /2018

V E N D I M

Nr. 247, Datë 05 / 12 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 162 Regjistri datë 15.10.2018, të grupit të personave: B. N dhe D. N, kundër Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, me pretendimin për diskriminim për shkak të *“aftësisë së kufizuar”* dhe të *“gjendjes ekonomike”*

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të sjellë para Komisionerit, subjektet ankues: z.B. N dhe z.D. N janë vëllezër dhe që të dy ndjekin studimet universitare pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD). Ata kanë ngritur shqetësimin për problematikën e krijuar mes tyre dhe këtij universiteti, lidhur me të drejtën e tyre për t’u përjashtuar nga tarifa e shkollimit. VKM nr.269, datë 23.09.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, ka parashikuar si kategori përfituese edhe kategorinë e studentëve me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me vendim KMCAP-je.

Universiteti i ka njoftuar se ata nuk mund të regjistrohen pasi nuk kanë realizuar pagesën për këtë vit akademik.

Subjektet ankues sipërcituar kanë të provuar me raporte mjekësore faktin e të qenurit persona me aftësi të kufizuar, specifikisht:

- Me Vërtetimin nr.2042/2016 të KMCAP të DRSSH Durrës, z. B. N cilësohet “I paaftë- me diagnozën “Hemophilia tip B”.
- Me Vërtetimin nr.404/2018 të KMCAP të DRSSH Durrës, z. D. N cilësohet “I paaftë- me diagnozën “Hemophilia tip B”.

Subjektet ankues shprehin shqetësimin se viti i ri shkollor sapo ka filluar dhe ata nuk kanë mundësi financiare për të kryer pagesat, për shkak se të ardhura të vetme kanë kempin, dhe janë në pamundësi ekonomike. Për më tepër ata janë përfitues të VKM-së sipërcituar dhe duhet të ishin regjistruar pa pagesë tashmë.

Subjektet ankues kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të ndërhyjë në mënyrë emergjente për zgjidhjen e situatës së tyre dhe zbatimin e VKM-së nr. nr.269, datë 23.09.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, me qëllim regjistrimin sa më parë të tyre.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së¹, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon

¹Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1404/1 prot., datë 16.10.2018, Komisioneri i ka kërkuar informacion Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, lidhur me problematikën e subjekteve ankues.

Me shkresën me nr.1603/1 prot., datë 02.11.2018 UAMD, ka informuar Komisionerin se:

“Studenti B. N është regjistruar për herë të parë pranë UAMD-së në vitin akademik 2017-2018 dhe as vitin e kaluar dhe as për këtë vit akademik nuk ka paraqitur asnjë kërkesë apo dokument me anë të të cilit të përcaktohet statusi i këtij studenti në lidhje me detyrimet financiare të tij ndaj institucionit tonë. Për rrjedhojë nuk jemi në kushtet e diskriminimit të këtij studenti për aq kohë sa pranë Administratorit apo Bordit të Administrimit nuk është përcjellë asnjë informacion apo dokumentacion mbi gjendjen shëndetësore të këtij studenti.

Studenti D. N është regjistruar për herë të parë pranë UAMD-së në vitin akademik 2018-2019. Edhe për këtë student nuk disponojmë asnjë informacion apo dokument mbi gjendjen e tij shëndetësore. Sqarojmë se aktualisht të gjithë studentët e regjistruar për herë të parë këtë vit akademik kanë filluar normalisht procesin mësimor dhe nuk kanë asnjë penalizim në lidhje me kryerjen e pagesës së tarifës së shkollimit.

Në lidhje me trajtimin e detyrimit financiar që kanë studentët të cilët janë me aftësi të kufizuar (KMCAP) ndaj UAMD-së, ju sqarojmë se (në zbatim të VKM nr.269/2017) në institucionin tonë janë përjashtuar nga tarifa vjetore e shkollimit të gjithë studentët të cilët janë pranuar në një program të ciklit të parë të studimeve, të cilët i përkasin kategorive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi. Studentët që plotësojnë kriteret e pikës 1 të këtij vendimi, pas paraqitjes së

dokumentacionit vërtetues për statusin e tyre, janë përjashtuar nga tarifa vjetore e studimit, me vendim të Bordit të Administrimit. Bordi i Administrimit, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur miraton për çdo vit akademik, jo më vonë se muaji dhjetor, listën e studentëve të kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1 të këtij vendimi. Për vitin akademik 2017-2018 janë përjashtuar nga tarifa 667 studentë të ciklit të parë”.

UAMD në përgjigjen e vet ka cilësuar se dokumentacioni që duhet të paraqesë çdo student i cili është me aftësi të kufizuar, është si më poshtë vijon:

- Kopje e noterizuar e Vendimit të KMCAP-së.
 - Vërtetim nga Njësia Administrative për trajtimin me pagesë paaftësie për këta persona.
 - Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) për trajtimin me pagesë paaftësie për këta persona.
 - Fotokopje e dokumentit të identifikimit.
 - Formulari për “Aplikimin për përjashtim nga tarifa e shkollimit”.
2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 20.11.2018², Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë ambjenteve të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. (UAMD)

Grupi i inspektimit të KMD-së u takua me përfaqësuesen e UAMD-së, znj.E. L, me pozicion Drejtore e Drejtorisë Ekonomike, e cila lidhur me pretendimin e paraqitur nga subjektet ankues, sqaroi se: *“Në asnjë moment këta dy studentë nuk janë diskriminuar nga ana e UAMD-së, pasi deri në datën 12.11.2018 nuk është pranuar dokumentacion për asnjë student të këtij universiteti, për shkak se Urdhëri për ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave të studentëve për përjashtim nga tarifa shkollore për vitin akademik 2018-2019, ka dalë me datë 09.11.2018 (ditën e premte) Për rrjedhojë nuk kishin si të diskriminoheshin në një kohë kur procedura për pranimin e dokumentacionit nuk ishte hapur ende”.* Nga verifikimi që iu bë databazës së UAMD-së nga ana e inspektorëve, rezultoi se, pranimi i dokumentacionit kishte filluar me datë 12.11.2018. Përfaqësuesja e UAMD-së theksoi faktin se studentët D. N dhe B. N mund të paraqiteshin për të depozituar dokumentacionin e kërkuar, i cili më pas do të vlerësohet nga ana e Bordit të Administrimit të UAMD-së. Nga ana e inspektorëve të KMD-së u konstatua fakti se në ambjentet e katit të parë të UAMD-së ishte afishuar njoftimi mbi afatin për paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar lidhur me studentët përfitues të VKM nr.269, datë 29.03.2017 për “Përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimin në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”.

² Në zbatim të Urdhërit nr.225, datë 14.11.2018, të Komisionerit.

Nga verifikimi i listës emërore të studentëve përfitues të kësaj VKM-je, për vitin akademik 2017-2018, rezultoi se kishin përfituar në total 667 studentë, nga të cilt 22 ishin studentë të së njëjtës kategori më ankuesit. (Bashkëngjitur procesverbalit të inspektimit është lista emërore përkatëse).

Përmes e-mailit zyrtar të Zyrës së KMD-së, palët në proces, me datë 03.11.2018, kanë dërguar kopje të dokumentacionit provues për depozitimin e dokumentacionit të ankuesve për përjashtimin nga tarifat e shkollimit për vitin akademik 2018-2019. (I cili rezulton që po me këtë datë është dorëzuar pranë UAMD-së).

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të padrejtë të ankuesve nga ana e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe të gjendjes ekonomike.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Nga këqyrja dhe verifikimi i informacioneve dhe dokumentacionit në dosje rezulton se:

- VKM nr.269, datë 29.03.2017 për “Përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, ka të përcaktuar shprehimisht se, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët të cilët janë pranuar në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, në institucionet publike të arsimit të lartë, të kategorive të mëposhtme:

Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë

10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) Studentët, familjet e të cilëve trajtohen /përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve...

Studentët sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1 të këtij vendimi, përjashtohen nga tarifa vjetore e studimit, pas paraqitjes së dokumentacionit vërtetues për statusin e tyre ligjor, me vendim të Bordit të Administrimit të Institucionit Publik të Arsimit të Lartë. Bordi i Administrimit të institucionit shqyrton dhe miraton për çdo vit akademik, jo më vonë se muaji dhjetor, listën e studentëve të kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij vendimi. Vendimi i Bordit të Administrimit të Institucionit Publik të Arsimit të Lartë i njoftohet Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit”.

Me shkresën me nr.1709/1 prot., datë 09.11.2018 Universiteti i Durrësit ka nxjerrë Urdhërin me nr.239/1, datë 09.11.2018 për “Për ngritjen e Komisionit, për shqyrtimin e kërkesave të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë, të cilët përmbushin kriteret, për përjashtim të plotë ose reduktim, në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, për vitin akademik 2018-2019”.

Në pikën 1, të këtij urdhëri është cituar përbërja e shtatë anëtarëve të Komisionit.

Në pikën 2, të tij, citohet se ky Komision do të marrë në dorëzim dhe do të shqyrtojë të gjitha kërkesat, dokumentacionin e depozituar nga studentët e ciklit të parë dhe të dytë të UAMD, të cilët përmbushin kriteret, për përjashtim të plotë ose reduktim, në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, për vitin akademik 2018-2019.

Pika 3, e tij ka përcaktuar se, studentët që kërkojnë të përfitojnë përjashtimin apo reduktimin e tarifës do të dorëzojnë kërkesën dhe dokumentacionin justifikues pranë zyrave të pagesës të studentëve pranë Fakulteteve përkatëse. Pas dorëzimit të dokumentacionit justifikues studenti dhe anëtari i komisionit i cili pranon dokumentacionin do të nënshkruajnë dokumentin/vërtetimin bashkëlidhur.

Në pikën 4, të tij, Urdhëri ka specifikuar se brenda datës 17.12.2018 Komisioni i sipërcituar do të përpilojë listën e studentëve të cilët kanë depozituar të gjithë dokumentacionin vërtetues/justifikues të përcaktuar në aktet përkatëse dhe do t’ia paraqesë atë Administratorit. Pas miratimit nga Bordi i Administrimit i listës emërore të studentëve përfitues, Drejtoria e Administrimit Financiar do të vijojë procedurat për çdo student.

Nga verifikimi që iu bë databazës së UAMD-së nga ana e inspektorëve të KMD-së rezultoi se, pranimi i dokumentacionit kishte filluar pas datës 09.11.2018, pra, pas daljes së Urdhërit për ngritjen e Komisionit të pranimit të dokumentacionit. Aplikimi i parë për këtë vit akademik pranë UAMD-së provohet të jetë bërë me datë 13.11.2018, nga studentja I.B pranë Fakultetit të FSP –së. Periudha për të cilën ankuesit kanë pretenduar se nga ana e UAMD-së u janë refuzuar t’u pranohej dokumentacioni, daton para daljes së urdhërit për ngritjen e Komisionit të pranimit të dokumentacionit. Për rrjedhojë nuk mund t’u pranohej as kërkesa dhe dokumentacioni për sa kohë ende nuk ishin përcaktuar: as anëtarët e komisionit dhe as detyrat e tyre respektive.

Referuar konfirmimit si të subjekteve ankues, ashtu dhe të përfaqësueses së UAMD-së, përmes e-mailit të datës 03.12.2018, provohet se me datë 03.12.2018 subjektet ankues janë paraqitur pranë UAMD-së për të dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me kërkesën e tyre për përjashtimin nga tarifat shkollore të vitit akademik 2018-2019. Po me këtë datë atyre u janë pranuar kërkesa dhe dokumentet e kërkuara. Theksojmë se data e pranimit të dokumentacionit provues për këtë vit akademik është: data 12.11.2018- 17.12.2018. (sipas Urdhërit nr. 239/1, datë 09.11.2018)

Sikurse përcaktohet në pikën 4, të Urdhërit nr. 239/1, datë 09.11.2018 për “Për ngritjen e Komisionit, për shqyrtimin e kërkesave të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë, të cilët përmbushin kriteret, për përjashtim të plotë ose reduktim, në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, për vitin akademik 2018-2019”, brenda datës 17.12.2018, Komisioni do të përpilojë listën e studentëve të cilët kanë dorëzuar dokumentacionin konform përcaktimeve dhe parashikimeve të akteve specifike dhe lista emërore e studentëve përfitues do të miratohet nga Bordi i Administrimit. Vetëm pas miratimit nga bordi, Drejtoria e Administrimit Financiar do të mund të vijoje procedurat për çdo student.

Urdhëri ka dalë me datë 09.11.2018. Subjektet ankues janë paraqitur për të aplikuar para kësaj date (dhe në këtë datë), pra, në një kohë kur ky urdhër nuk kishte hyrë në fuqi akoma, pasi zbatimi i tij ka nisur me datë 12.11.2018.

Në këto rrethana, ata nuk mund të jenë trajtuar në mënyrë të pafavorshme nga ana e UAMD-së, përmes mospranimit të kërkesës dhe dokumentacionit të tyre, për sa kohë procedura nuk ishte hapur ende. (Referuar datave që ata pretendojnë se nuk u janë pranuar kërkesat). Aktualisht, procesi vijon dhe nuk ka përfunduar ende. Ankuesve u janë pranuar kërkesat dhe dokumentacioni në momentin që ata kanë shkuar për t’i depozituar, pra me datë 03.12.2018, pas daljes së Urdhërit përkatës të UAMD-së lidhur me këtë proces.

Pra, aktualisht, deri në datën 17.12.2018 procedura për pranimin e kërkesave dhe dokumentacionit përkatës të studentëve që kërkojnë të përjashtohen nga tarifat e shkollimit për vitin akademik 2018-2019 është ende e hapur. Subjektet ankues kanë dorëzuar kërkesën e tyre dhe dokumentacionin

provues bashkëngjitur, brenda afatit kohor të përcaktuar në Urdhërin specifik të UAMD-së (sipërcituar) dhe janë në proces vlerësimi akoma.

Aktualisht, B. N ndjek studimet në vitin e dytë në Fakultetin e Sudimeve Profesionale pranë UAMD-së, ndërsa D. N ndjek studimet në vitin e parë në Fakultetin e Sudimeve Profesionale pranë UAMD-së.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Në këto kushte, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri gjykon se grupi i studentëve që kanë paraqitur ankesë pranë KMD-së³ nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Universitetit të Durrësit, sa i takon mospranimin të dokumentacionit të paraqitur pranë këtij Universiteti, në muajin Nëntor 2018, për të qenë përfitues të përjashtimit nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2018-2019.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur nenet 1, 2, 3, pika 1, neni 4, pika 1, neni 7, pika 1, neni 17, pika 1, germa ç) neni 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

- 1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar dhe të gjendjes ekonomike, të subjekteve ankues: B. N dhe D. N, nga ana e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.**

³ B. N dhe D. N.

2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(shkaku: aftësia e kufizuar, gjendja ekonomike)

(fusha: arsim)